



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 583 / Prot  
1

Tiranë, më 02/06/2020

VENDIM

Nr. 12, datë 02.06.2020

PËR

MOSPRANIMIN E ANKESËS

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 (a) (i) të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. \_\_\_\_\_, përfaqësuar nga Av. \_\_\_\_\_, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 583 Prot., datë 26.05.2020, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Me shkresën nr. 24867 prot., datë 12.12.2019, ankuesi ka kërkuar nga Autoriteti Publik:

- *Të marrë masa për kryerjen e menjëhershme të pagesave të konsumit të energjisë elektrike të debive të akumuluarra Shtator – Tetor – Nëntor nga shoqëria Belavis sh.p.k dhe të mos ngarkojë poseduesin e kësaj kontrate z. \_\_\_\_\_ në cilësinë e qiradhënësit.*

Me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankesë pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njej ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe verifikimit të fakteve dhe bazës ligjore të saj, Komisioneri konstaton se ankesa është paraqitur jashtë afatit ligjor të parashikuar në pikën 2, të nenit 24 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i cili parashikon

se: "Ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit; b) ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit."

Sa më sipër, rezulton se nuk është përmbushur detyrimi për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga kushtet formale të nevojshëm për marrjen në shqyrtim të ankesave. Mosrespektimi i afatit të ankimit, përbën shkak për mos pranimin e ankesës.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se ankesa e z. \_\_\_\_\_ ndaj Autoritetit Publik/Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, është paraqitur përtej afatit të parashikuar në pikën 2 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe si e tillë nuk mund të merret në shqyrtim.

Gjithashtu, pavarësisht afatit, referuar legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit bashkëlidhur, konstatohet se ankesa është jashtë objektit të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Kërkesa/ankesa nr. 24867 prot., datë 12.12.2019 "Mbi likuidimin e plotë të debive të kontratës" e depozituar nga ankuesi pranë autoritetit publik, me anë të së cilës kërkon marrjen e masave për kryerjen e menjëhershme të pagesave të konsumit të energjisë elektrike të debive ..., tejkalon qëllimin e njohjes me dokumentacion publik sipas parashikimit të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit". Kjo përgjigje mbetet në diskrecion të autoritetit publik në kuadër të ushtrimit të detyrave funksionale dhe veprimtarisë së këtij të fundit.

Bazuar në pikën 2 të nenit 2 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", parashikohet se: "*informacion publik*" është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik". Në këtë kuptim, mund të kërkohet çdo informacion/dokument i cili është prodhuar ose mbahet nga autoriteti publik dhe jo një veprim që lidhet me detyrën funksionale të këtij të fundit.

## PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën a), i) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 'Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative' i ndryshuar,

## V E N D O S A:

1. Mospranimin e ankesës nr. 583 Prot., datë 26.05.2020 të z. \_\_\_\_\_, përfaqësuar nga Av. \_\_\_\_\_, kundër Autoritetit Publik "Operatorit të Shpërndarjes së

Energjisë Elektrike”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.

2. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
3. Ky vendim u shpall sot në datë 02.06.2020.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

